



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
REKTORATI

Nr. 303 / Prot

Durrës, më: 02.02 2026

V E N D I M

Nr. 04, datë 02.02 2026

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së, në mbledhjen e datës 02.02.2026, Rektorati,

V E N D O S I:

1. Ngarkimin e Zv. Rektores për anën mësimore dhe Drejtuesit e Njësive Kryesore, për marrjen e masave për mbarëvajtjen e procesit të zhvillimit të provimeve përfundimtare të semestrit të parë të v.a 2025-2026 si dhe organizimin e sezonit të dimrit në përputhje me Rregulloren e UAMD-së;
2. Ngarkimin e Zv. Rektores për anën mësimore, Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Drejtorinë e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave për marrjen e masave për monitorimin e procesit të zhvillimit të provimeve përfundimtare të semestrit të parë të v.a 2025-2026 (zhvillimi i provimeve sipas grafikut, prania e asistentit).
3. Ngarkimin e Administratorit për marrjen e masave për riparimin dhe zëvendësimin e pajisjeve të ndryshme të dëmtuara, pajisjet e sistemit të ngrohjes dhe ftohjes, si pasojë e përmbajtjeve të datës 06.01.2026, si dhe marrjen e masave për pajisjen e stafit me kompjutera, **brenda datës 15.02.2026.**
4. Ngarkimin e Drejtuesve të Njësive Kryesore për hartimin e Projekt Strategjisë së Profilizimit përmes Ndërkombëtarizimit, 2025-2030, sipas specifikave të fakulteteve, **brenda muajit Shkurt 2026.**
5. Miratimin paraprak dhe kalimin për miratim përfundimtar në Senatin Akademik të kuotave të pranimit të studentëve për Ciklin e Parë të Studimeve Bachelor, programet e studimit me karakter profesional 2-vjeçar, Program i Integruar i Studimeve, Master i Shkencave dhe Master Profesional, për vitin akademik 2026 – 2027 në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës;
6. Kalimin e projekt Buxhetit të vitit 2026 për shqyrtim Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS).
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore

- Drejtoria e Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave
- Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit
- GMS

8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI

